



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:139911

Datë: 13.09.2019

Numri i dokumentit: 00529369

PKR.nr.99/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me kryetarin e trupit gjykues-gjyqtarin Sahit Krasniqi, dhe me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të pandehurit F.V, për shkak të vepres penale, mbajtja në pronësi, në kontroll, ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe vepren penale përdorimi I armës apo I mjetit të rrëzikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti per Krime te Renda PP/L.nr.78/19 të datës 04.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 13.09.2019, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës prokurorit të shtetit Rasim Maloku, të pandehurit F.V dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. V.J, të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **F.V**, I lindur me dt. në ..., nga I ati Q..dhe e ëma R..., e vajzërisë B..., me vendbanim në, shqiptar, shtetas I R. Kosovës, me profesion punëtor – shofer I mjeteve të rënda, ka të kryer shkollen e mesme, I martuar, babe I tre fëmijëve, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me dt. 28 maj 2019, rreth ores 13:30, në Hanë të Elezit në rrugën “...” ka mbajtur në posedim pa autorizim armën në kundërshtim me nenin 5 të ligjit mbi armët 05/L-022, në atë

mënyrë që derisa ka qenë me veturën e tij me Mercedes ngjyrë të zezë, me targa, ka poseduar pa autorizim revolen e tipit të panjohur, e kalibrit 7.65mm, ngjyrë e zezë, me një karikator me dy fishek,e cila pastaj iu është sekuestruar nga ana e policies.

- **Me çka kreu vepren penale mbajtja në pronësi, në kontroll, ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPK-së.**

-

Sepse: me date 28 maj 2019, rreth ores 13:30 në Hanë të Elezit në rrugen “.....”, ka përdorur pa autorizim armën në kundërshtim me nenin 5 të ligjit mbi armët numer 05/L-022, në atë mënyrë që derisa ka qenë me veturen e tij të tipit Mercedes ngjyrë e zezë, me targa, ka shtënë dy here me revolen e tipit të panjohur të kalibrit 7.65 mm, ngjyrë e zezë

- **Me çka ka kryer vepren penale përdorimi I armës apo I mjetit të rrëzikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.**

Në bazë të dispozitës së sipërcituar dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 par.1 nënpar. 1.2 , të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së ,të pandehurit i,

SHQIPTON

Për vepren penale të përshkruar në dispozitivin I të aktakuzes I shqipton **Dënim me gjobë në lartësi prej 400/katërqindë/euro**, të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Për vepren penale të përshkruar në dispozitivin II të aktakuzes I shqipton **Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej **1/një/viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, dhe

Ne baze te nenit 76 par. 2 nënpar. 2.5 te KPRK-se, te akuzuarin e :

G J Y K O N

Me DËNIM UNIK burgimi ne kohëzgjatje prej **prej 1/një/viti** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej **1/një/viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, dhe **Denim me gjobe** ne lartësi prej **400/katërqind/euro**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar me gjobë të pandehurit do të llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga data 28.05.2019 deri me datën 30.05.2019.

Ne rast se dënimi me gjobe nuk mund të ekzekutohet ne format tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do të shndërrohet ne dënim burgu, ashtu që për çdo 20 euro të pandehurit do të llogaritet një ditë burgu.

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme revolva e tipit të pa njohur e kalibrit 7.65 mm, ngjyrë e zezë, dhe një karikator me 2 fishekë.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 / tridhjetë / euro, si dhe të paguaj shumën prej 50 / pesëdhjetë / euro në Fondin për kompensimin e viktimave të dhunës, të gjitha këto në afat prej 15 / pesëmbëdhjetë / ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.78/19 të datës 04 korrik 2019 ka ngarkuar të pandehurin F.V, për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe veprën penale përdorimi I armës apo I mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.09.2019, në të cilën prokurori i shtetit Rasim Maloku ka bërë përmirsimin e kualifikimit juridik të veprës penale të përshkruar në dispozitivin II të aktakuzës ku në vend të nenit 375 par.1 të KPRK-së, duhet të jetë neni 367 par.1 të KPRK-së dhe ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së ngritur dhe cilësimit juridik të veprave penale duke shtuar se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare i cili pranim përputhet me të gjitha provat të cilat

gjinden në shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të i shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri F.V në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale me të cilën e ngarkon aktakuza në të gjitha pikat duke shtuar se është penduar për kryerjen e këtyre veprave penale dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, dhe I ka propozuar gjykatës që të I shqiptojë një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i autorizuar i të pandehurit F.V, av. V.J deklaron se i pandehuri në mënyrë vullnetare e ka bërë pranimin e fajësisë për veprat penale që i vihen në barrë, dhe i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të zbatoj institutin e zbutjes së dënimit dhe të pandehurit të i shqiptoj një dënim të kushtëzuar duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë, pendimi i të pandehurit për veprat e kryera, premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme.

Gjykata konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- I pandehuri kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,
- pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. V.J,
- i cili pranim mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit siç janë: raporti I oficerit I dates 28.05.2019, lista e armëve të konfiskuara I dt. 28.05.2019, dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës,
- dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata vlerësoi se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, meqë me datë kohë dhe vend siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri deri sa ka qenë me veturën e tij tipit Mercedes ngjyrë të zezë me targa ka poseduar pa autorizim revolen e tipit të panjohur, kalibri 7.65 mm, dhe një karikator me dy fishek, dhe të njëjtën armë e ka përdorur duke shtënë dy herë në ajër.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht **lehtësuese** mori faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale, ndërsa si rrethana lehtësuese mori parasysh pendimin e shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale, si dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra te tilla penale. Në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale. Mbi bazën e rrethanave të tilla gjykata konform nenit 71 par.1 nënpar. 1.2 të KPRK-së aplikoi institutin e zbutjës së dënimit për veprën penale përdorimi I armës apo I mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe të pandehurit i shqiptoi dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej **1/një/viti** i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej **1/një/viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, **dhe Dënim me gjobë në lartësi prej 400 /katër qind/ euro** të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj ne afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi te merr formën e prere, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Konform nenit 79 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar me gjobë të pandehurit I është llogaritur edhe koha e kaluar në ndalim nga data 28.05.2019 deri me datën 30.05.2019.

Konform nenit 366 par.3 te KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme revolja e tipit të pa njohur e kalibrit 7.65 mm, ngjyrë e zezë, dhe një karikator me 2 fishekë.

Vendimi për paushallin gjyqësor është i bazuar në nenin 450 të KPPK-së duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, ndërsa vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të dhunës bazohet në nenin 39 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit- Ligji nr.05-L-036.

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA PKR.nr.99/19 të dt. 13.09.2019.**

Sek.Juridike

Adelina Sallahu

Kryetari i trupit gjykues

Sahit Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes kësaj Gjykate.